

Ne perputhje me Nenin 28, paragrafi i 3-te i Ligjit 97/2007, Per Qendren Kombetare te Regjistrimit, ky dokument perben:

**AKT THEMELIMI**  
**DHE**  
**STATUTI I**  
**SHOQERISE AKSIONARE ME OFERTE PRIVATE**  
**(ME AKSIONAR TE VETEM)**  
**“HIB - PETROL” SH.A.**

Sot me date 29 Janar 2024, pala e meposhtme:

**Z.Kujtim BUCALIU**, shtetas shqiptar, atesia Ibrahim dhe amesia Fatmire, lindur në Prishtine, Kosove, më 20.04.1979, banues në Durres, në adresën: Njesia 5, Rruga "Turgut Ozal", Nd. 056, Durrës, 2008, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 034184819 dhe Nr.Personal H90420292M, i perfaqësuar me Prokure date 19.01.2024 nga Ndue Pjetrushaj.

vendosin te nenshkruajne kete Akt Themelimi dhe Statut per krijimin e nje shoqerie aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**TITULLI 1**  
**EMRI I SHOQERISE-SELIA E REGJISTRUAR-KOHEZGJATJA**

**Neni 1 – Emri i Shoqerise**

- 1.1 Shoqeria e emertuar **HIB - PETROL Sh.a.** ( ne vijim referuar si “Shoqeria”) eshte nje shoqeri aksionare me oferte private e krijuar, me aksionar te vetem dhe e organizuar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.
- 1.2 Shoqeria ka vulen zyrtare dhe logon e saj.

**Neni 2 – Selia Ligjore**

- 2.1 Selia e regjistruar e Shoqerise eshte ne adresen: Njesia Bashakiake Nr. 5, Rruga Emin Duraku, Pallati Binjaket Nr. 5, Kati 1 teknik, Ap. 1&2, Tirane, Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te hape apo te mbylle dege dhe/ose zyra perfaqesimi ne Shqiperi dhe/ose jashte saj.
- 2.3 Ne lidhje me marredheniet ndermjet Shoqerise dhe aksionareve, adresa per shkak te detyres te cdo aksionari do te jete adresa qe percaktohet ne regjistrin e aksionareve te Shoqerise. Ne rast ndryshimi te kesaj adrese, aksionari perkates do te njoftoje menjehere me shkrim Shoqerine dhe ndryshimi do te pasqyrohet ne regjistrin e aksionareve te Shoqerise.

**Neni 3 – Kohezgjatja**

- 3.1 Shoqeria eshte krijuar per nje afat te pacaktuar.



## TITULLI II

### OBJEKTI

#### Neni 4 – Objekti

##### 4.1 Objekti i Shoqerise, do te perfshije, por, nuk kufizohet ne aktivitetet e meposhtme:

Tregtimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve, perfshire ato bio, si dhe lende djegese, duke perfshire gjithashtu si me poshte vijon: tregtimi me shumice i naftes bruto e nenprodukteve te saj te kategorive 0, II, III, IV e V, me perjashtim te nenprodukteve qe destinohen per furnizimin e mjeteve te fluturimit ajror; tregtimi me shumice i gazit te lengshem te naftes, kategoria I, perfshire edhe mbushjen e bombolave me kete nenprodukt; tregtimi me shumice i karburanteve, kategorite II/B e III/C, per mjetet e fluturimit. Import eksport tregti me shumice e pakice te karburanteve, lubrifikanteve, vajrave, graso, gaz e lende djegese te te gjitha llojeve dhe kategorive; Prodhim, eksport-import, tregtim te materialeve te 2 ndertimit, si dhe te materialeve qe perdoren per industrine e naftes, gazit, ujit dhe minierave; Ushtrimin e tregtise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, pajisje e materiale te ndryshme hidraulike dhe elektrike dhe ne pergjithesi çdo aktivitet plotesues; Import dhe eksport mallra e pajisje te te gjitha llojeve, makineri e pajisje si dhe aktivitetin e shperndarjes dhe perdorimit te tyre, per vete shoqerine dhe per te tjere; Te kryeje furnizime te impianteve dhe pajisjeve teknike per aktivitetet qe operojne dhe qe kane lidhje me asetet e shoqerise; Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime te objekteve te ndryshme industriale e civile, prodhim te inerteve dhe materiale ndertimi, financime qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise si dhe cdo veprimtari tjetër qe nuk bie ne kundërshtim me ligjin; Shoqeria do te kryeje veprimtari ne fushen e hotelerise, turizmit, ushqimit, administrimit, te internet kafese, perfshire administrimin e aktiviteve te lidhura me te si bar-kafe dhe sherbime si fotokopje, shitje te vogla kancelarie dhe materiale te konsumit te aktiviteve te tjera te ketij lloji. Te hyje ne veprimtari tregtare qe jane ne realizimin e qellimit te saj tregtar; Shoqeria mund te kryeje drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne shoqeri te tjera te zhvilloje cdo lloj aktiviteti qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre; Te importoje, eksportoje dhe tregtoje makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme te te gjitha llojeve. Te ofroje dhe te kryeje sherbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare. Te organizoje kurse formimi dhe specializimi. Furnizimi me karburant per mjetet lundruese.

##### 4.2 Me qellim permbushjen e objektit te lartpermendur, Shoqeria gjithashtu, mund te:

- (a) kryeje cdo aktivitet me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme si dhe aktivite tregtare, financiare, qira apo hipotekore te cilat mund te konsiderohen te dobishme apo te nevojshme per permbushjen e objektit te Shoqerise;
- (b) bleje, ne menyre te drejtperdrejte apo te terthorte, interesa ne shoqeri te tjera qe kane objekt te ngjashem me ate te Shoqerise, ne Shqiperi apo jashte saj; dhe





- (c) kryeje cdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.
- 4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryeje cdo aktivitet tjetër i cili nuk ndalohej nga ligji i zbatueshëm.

### TITULLI III

#### KAPITALI AKSIONAR – AKSIONET – TRANSFERIMI

##### Neni 5 – Kapitali aksionar

- 5.1 Kapitali aksionar i nënshkruar i Shoqërisë është 4,000,000.00 (kater milion) Leke, i ndarë në 100 (njëqind) aksione të zakonshme me vlerë nominale 40,000.00 (dyzet mijë) Leke secili, i zotëruar 100% nga aksionari i vetëm, **Z. Kujtim Bucaliu**, shtetas shqiptar, lindur më 20.04.1979, në Prishtinë, Kosovë, mbajtes i letërnjoftimit me nr.034184819 dhe nr.personal H90420292M.
- 5.2 Asambleja e Përgjithshme përbehet nga Aksionari i Vetëm zotëruar i 100% të kapitalit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit aksionar me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimin të kufizuar të kapitalit aksionar, zmadhimin të autorizuar të kapitalit aksionar, kalimit në kapitalin bazë të rezervave të disponueshme dhe të fitimeve të pashpërndara, emetimit të obligacioneve të konvertueshme dhe rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.
- 5.3 Në rast:
- (a) zmadhimi të kapitalit aksionar nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja, aksionaret ekzistues kanë të drejtën e parblerjes të aksioneve të reja *ne proporcion me* numrin e aksioneve që këto zotërojnë;
  - (b) zmadhimi të kufizuar të kapitalit aksionar, aksionet e reja do t'u ofrohen vetëm aksionareve ekzistues;
  - (c) zmadhimi të autorizuar të kapitalit aksionar, aksionet e reja mund t'u ofrohen punonjësve të Shoqërisë apo punonjësve të shoqërive të tjera, pjesë e të njëjtit grup shoqëror;
  - (d) zmadhimi të kapitalit aksionar nëpërmjet kalimit në kapitalin bazë të rezervave të disponueshme dhe të fitimeve të pashpërndara, aksionaret ekzistues kanë të drejtën e parblerjes të aksioneve të reja *ne proporcion me* numrin e aksioneve që këto zotërojnë;
  - (e) zmadhimi të kapitalit aksionar nëpërmjet emetimit të obligacioneve të konvertueshme të Shoqërisë në aksione, aksionaret ekzistues kanë të drejtën e parblerjes të këtyre obligacioneve *ne proporcion me* numrin e aksioneve që këto zotërojnë;



(f) rritje te vleres nominale te aksioneve ekzistuese, kjo rritje do te paguhet nga aksionaret ekzistues ne menyre proporcionale.

5.4 Asambleja e Pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin aksionar te Shoqerise nepermjet zvogelimit te vleres nominale te aksioneve, zvogelimit te thjeshtezuar te kapitalit aksionar apo anulimit te aksioneve por ne asnje rast kapitali aksionar nuk mund te jete me i vogel se kapitali i regjistruar i shoqerise.

#### **Neni 6 – Aksionet**

6.1 Aksionet jane te zakonshme.

6.2 Akti i emertimit te aksioneve hartohet ne castin e emetimit fillestar te aksioneve dhe ky akt permban te dhenat dhe duhet te jete ne perputhje me procedurat e percaktuara ne ligjin e zbatueshem.

6.3 Cdo aksion jep te drejten e nje vote.

6.4 Keshilli i Administrimit harton dhe mban regjistrin e aksionareve te Shoqerise ne seline e regjistruar te Shoqerise i cili duhet te permbaje: emrin dhe mbiemrin apo emrin e shoqerise, numrin e aksioneve, vleren nominale te aksionit, adresen per shkak te detyres apo adresen zyrtare te aksionarit dhe daten e regjistrimit te transakcionit.

6.5 Aksionaret e regjistruar ne regjistrin e aksionareve do te prezumohen se jane aksionare te Shoqerise te cilet kane cdo dhe te gjitha te drejtat qe lidhen me kete cilesi ne marredheniet e tyre me Shoqerine dhe me pale te treta.

#### **Neni 7 – Transferimi i aksioneve**

7.1 Aksionet e Shoqerise mund te barresohen, cedohen apo transferohen lirisht tek pale te treta, teresisht apo pjeserisht.

7.2 Cdo transferim i te drejtes se pronesise lidhur me aksionet e Shoqerise si edhe krijimi apo transferimi i cdo te drejte tjeter lidhur me keto do te regjistrohet ne regjistrin e aksionareve.

### **TITULLI IV**

#### **SEKSIONI I**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 8 – Organet e Shoqerise**

Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Keshilli i Administrimit;
- 3) Administrator/et; dhe
- 4) Eksperti/et Kontabel i Autorizuar.





## SEKSIONI II

### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

#### Neni 9 – Asambleja e Pergjithshme

- 9.1 Organi vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e cila perbehet nga Aksionari i Vetem i Shoqerise.
- 9.2 Cdo aksionar ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe per te votuar ne proporcion me aksionet qe ai zoteron.
- 9.3 Cdo aksionar ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht aksionar, me prokure me shkrim. Ne cdo rast, prokura do te jepet vetem per nje mbledhje Asambleje te Pergjithshme e vlefshme per thirrjen e saj te pare dhe te dyte.
- 9.4 Aksionari nuk mund te leshoje prokure per te votuar per nje pjese te aksioneve te tij kur voton personalisht per pjesen tjetër te aksioneve te tij.
- 9.5 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet ne nje vend tjetër nga selia e regjistruar e shoqerise, brenda Republikës se Shqiperise apo jashte saj.
- 9.6 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Keshilli i Administrimit apo Administratori sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interest e Shoqerise apo sipas ligjit te zbatueshem apo kur kerkohet nga nje aksionar/et te cilet perfaqesojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit aksionar apo nga cdo person tjetër i autorizuar sipas ligjit te zbatueshem. Ne cdo rast, Asambleja e Pergjithshme do te thirret te pakten nje here ne vit, jo me vone se muaji qershor i cdo viti me qellim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit financiar te meparshem.

#### Neni 10 – Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

- 10.1 Vendimet e zakonshme merren me shumicen e thjeshte te kapitalit aksionar te Shoqerise.
- 10.2 Asambleja e Pergjithshme merr vendime te zakonshme lidhur me ceshtjet e meposhtme:
  - (a) percaktimin e politikave tregetare, plan biznesn vjetor te Shoqerise si edhe te gjithe rregullat dhe rregulloret e brendshme, perfshire por pa u kufizuar ne kodin etik she moral te Shoqerise, etj;
  - (b) emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit;
  - (c) emerimin dhe shkarkimin e ekspertit/ve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
  - (d) percaktimin e skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat (b) dhe (c);
  - (e) miratimin dhe zbatimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te bilancit e te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - (f) shitje apo blerje e asetëve (qofte me blerje kapitali apo asete, bashkim apo ndyshe);



- (g) marrja persiper e detyrimeve;
  - (h) riorganizimi, prishja, shnderrimi, bashkimi, shkrirja, perthithja, shperberja apo likujdimi i Shoqerise apo riorganizimi i Shoqerise ne nje forme tjeter ligjore.
  - (i) Perfaqesimi i Shoqerise ne gjykate dhe ne procese te tjera kunder anetareve te Keshillit te Administrimit apo Administratorit;
  - (j) miratimi dhe ekzekutimi i kontratave te huase me banka, institucione bankare apo institucione te tjera huadhenese;
  - (k) miratimi leter krediti, overdraft dhe te ngjashme me institucione financiare;
  - (l) miratim per krijim barre mbi aksionet, pasuri te luajtshme dhe/ose te paluajtshme te Shoqerise;
  - (m) krijimi dhe miratimi i standarteve te punesimit per te gjithë punonjesit e Shoqerise dhe krijimi e miratimi i struktures se punonjesve te Shoqerise;
  - (n) ndryshimi i dates referuese kontabel apo politikave kontabel;
  - (o) kryerje e ndryshimeve ne planet strategjike, zonen gjeografike apo drejtimet e aktivitetit te Shoqerise te cilet nuk parashikohen ne plan biznes;
  - (p) percaktimi i politikave ne lidhje me skemen minimale dhe maksimale te shperblimit per secilin dhe te gjitha pozicionet e punes ne Shoqeri;
  - (q) cdo ceshtje tjeter qe percaktohet nga ligji i zbatueshem dhe nga ky Statut.
- 10.3 Ne rastin e vendimeve qe kerkojne shumice te cilesuar, keto do te merren me voten pro e te pakten  $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e kapitalit aksionar te Shoqerise.
- 10.4 Asambleja e Pergjithsshme merr vendime me shumice te cilesuar per ceshtjet e meposhtme:
- (a) ndryshime apo shtesa te Statutit te Shoqerise;
  - (b) zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit apo krijimi, shperndarja apo emetim i aksioneve apo cdo titull tjeter apo dhenie e cdo opsioni apo te drejta per nenshkrim apo konvertimin e cdo instrumenti ne aksione apo tituj;
  - (c) shperndarja e fitimeve vjetore;
  - (d) pjesetimin e aksioneve dhe anullimin e tyre;
  - (e) ndryshim ne te drejta qe lidhen me aksione te kategorive te vecanta apo cdo perfitim, blerje apo posedim tjeter nga ana e Shoqerise e cdo aksioni apo obligacione te tjera te Shoqerise;
  - (f) ndryshim i perberjes se Keshillit te Administrimit;



- (g) kryerja e veprimeve qe ne menyre te arsyeshme mund te rezultojne ne nje Rast Likuidimi;
  - (h) riorganizimi, prishja, shnderrimi, bashkimi, shkrirja, perthithje, shperberja apo likuidimi i Shoqerise apo riorganizimi i Shoqerise ne nje forme tjeter ligjore.
- 10.5 Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme dhe me vendime qarkulluese qe komunikohen me poste te regjistruar apo korrier si edhe me Faks te cilet duhet te nenshkruhen nga aksionari (et) apo perfaqesuesit e tyre te autorizuar.

### SEKSIONI III

#### KESHILLI I ADMINISTRIMIT

##### Neni 11 – Keshilli i Administrimit

- 11.1 Keshilli i Administrimit perbehet nga 3 (tre) anetare, te cilet emerohen nga Asambleja e Pergjithshme.
- 11.2 Anetaret e Keshillit te Administrimit emerohen per nje afat prej 3 (tre) vjetesh dhe mund te ri-zgjidhen.
- 11.3 Asambleja e Pergjithshme emeron Kryetarin e Keshillit te Administrimit midis anetareve te tij i cili ka gjithashtu te drejten e nje vote shtese.
- 11.4 Administratori i Shoqerise emerohet me shumice te thjeshte nga anetaret e Keshillit te Administrimit.
- 11.5 Anetaret e pare te Keshillit te Administrimit te Shoqerise emerohen me ane te ketij Akti Themelimi dhe Statuti dhe jane si me poshte:
  - 1. **Z.Almarin Haxhija**, shtetas shqiptar, lindur me 28.10.1986, ne Lezhe, mbajtes i leternjoftimit nr. I61028030Q, ne postin e Kryetarit;
  - 2. **Z.Kristian Haxhija**, shtetas shqiptar, lindur me 24.12.1998, ne Lezhe, mbajtes i leternjoftimit nr. J81224021G, ne postin e anetarit; dhe
  - 3. **Zj.Donika Pjetrushaj**, shtetase shqiptare, lindur me 30.10.1967, ne Tale, mbajtese e pasaportes me nr.pesronal G76030104E, ne postin e anetarit.

##### Neni 12 – Mbledhjet e Keshillit te Administrimit

- 12.1 Keshilli i Administrimit do te mblidhet sa here kerkohet per te mbrojtur intereset e Shoqerise. Kryetari i Keshillit te Administrimit mund te therrase mbledhjen e Keshillit te Administrimit ne cdo kohe, me kusht qe, anetaret e Keshillit te Administrimit te marrin njoftim te pakten 72 (shtatedhejte e dy) ore perpara cdo Mbledhje te Keshillit te Administrimit apo cdo anetar te heqe dore me shkrim nga njoftimi i Mbledhjes. Kerkesa duhet te permbaje rendin e dites. Cdo mbledhje mund te mbahet me pranine personalisht apo me telekonference apo me mjete te ngjashme komunikimi, me kusht qe, te gjithë



anetaret qe marrin pjese ne mbledhje te dergojne njeri-tjetrin dhe Kryetari i Keshillit te Administrimit te nenshkruaje rregullisht procesverbalin.

- 12.2 Keshilli i Administrimit mund te caktojte nje sekretar per mbajtjen e proceverbalit.  
Sekretari mund te jete anetar apo jo i Keshillit te Administrimit.
- 12.3 Mbledhjet e Keshillit te Administrimit thirren rregullisht kur jane te pranishem shumica e anetareve te tij, me kusht qe, ne mbledhje te jete i pranishem Kryetari i saj.
- 12.4 Megjithate Keshilli i Administrimit merr vendim edhe me qarkullore me shkrim pa qene e nevojshme thirrja apo mbajtja e nje mbledhje, me kusht qe, ky akt te nenshkruhet ng ate gjithë anetaret e tij.
- 12.5 Keshilli i Administrimit merr vendime te vlefshme me voten pro te shumices se anetareve te pranishem ne mbledhje.
- 12.6 Mbledhjet e Keshillit te Administrimit do te zhvillohen ne gjuhen shqipe dhe cdo material me shkrim qe do te diskutohet ne kete mbledhje do te jete ne shqip. Vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve do te pergatiten menjehere pas cdo mbledhje dhe do te nenshkruhen nga Kryetari. Ne rastin kur kerkohet qe vendimet dhe proceverbalet e mbledhjeve apo dokumente te tjera te lidhura te jene ne gjuhen shqipe si rrjedhoje do te sigurohet edhe perkthimi i ketyre ne Anglisht i cili ka perparesi.

### **Neni 13 – Kompetencat e Keshillit te Administrimit**

- 13.1 Keshilli i Administrimit ka te gjitha kompetencat lidhur me mbikeqyrjen dhe kontrollin e veprimtarise se Administratorit si edhe kryerjen e aktivitetit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te Shoqerise nga ky i fundit, pervec atyre kompetencave qe sipas ketij Statuti, Marreveshjes se Aksionareve apo ligjit te zbatueshem iu rezervohen organeve te tjera.
- 13.2 Pervec, detyrimeve ligjore dhe pergjegjesive sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare, Keshilli i Administrimit ka kompetencat dhe detyrat e meposhtme:
  - (a) kontrolli dhe mbikeqyrja e drejtimit te Shoqerise dhe zbatimi i politikave tregtare, plan biznesit te Shoqerise nga Administratoret e Shoqerise;
  - (b) me kerkese te Asamblese se Pergjithshme, merr masa per pergatitjen e drafteve te nevojshem dhe draft vendimeve qe jane competence e Asamblese se Pergjithshme dhe jep rekomandime;
  - (c) therret Asamblene e Pergjithshme sa here e quant e nevojshme;
  - (d) emeron dhe shkarkon Administratoret e Shoqerise dhe cakton shperblimet e tyre;
  - (e) miraton transakcione apo veprime te tjera qe lidhen me aktivitetin e zakonshem te Shoqerise dhe jane dukshem pjese e plan biznesit me shkrim te Shoqerise te miratuar nga Asambleja e Pergjithshme;





- (f) miraton kriteret e punesimit nga Administratori i Shoqerise sic percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme dhe sipas struktures se Shoqerise te miratuar nga Asambleja e Pergjithshme si edhe miraton cdo punesim dhe pozicione pune perpara kryerjes se cdo pune apo marreveshje te ngjashme nga Administratori i Shoqerise.
- (g) te miratoje marrjen persiper te detyrimeve me vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare, te certifikuara, nepermjet nenshkrimit te huave apo cmetimit te obligacioneve apo instrumenteve te tjera te borxhit.

## SEKSIONI IV

### ADMINISTRATORET

#### Neni 14 – Administratori

##### Kompetencat e Administratorit te Shoqerise

- 14.1 Administratori (“**Administratoret e Shoqerise**”, “**Administroret**”) eshte person fizik, i cili mund te jete ose jo anetar i Keshillit te Administrimit dhe propozohet dhe emerohet nga Keshilli i Administrimit dhe me diskrecionin e tyre mund te shkarkojne ne cdo kohe Administroret per cfaredolloj shkak qe keto quajne te arsyeshem.
- 14.2 Administratori ka te gjitha kompetencat te kryeje veprime ne lidhje me administrimin e zakonshem te shoqerise te cilat jane te nevojshme per permbushjen e objektit te Shoqerise pervec kompetencave qe u rezervohen organeve te tjera sipas ketij statuti dhe ligjit te zbatueshem. Keto kompetenca dhe veprime jane te vlefshme dhe detyruese vetem me nenshkrimin e Administratorit.
- 14.3 Administratori i pare i Shoqerise eshte:
  - **Z. Ndue Petrushaj**, shtetas shqiptar, lindur me 31.08.1966, ne Lezhe, mbajtes i leternjoftimit me nr. personal G60831090F.
- 14.4 Administratori i Shoqerise duhet t’i raportoje Keshillit te Administrimit ne cdo kohe kur kerkohet dhe ne rast te kundert keto shkarkohen automatikisht nga detyra.
- 14.5 Ne rast se Administratori ka nje interes apo ate ten je pale te trete ne nje transaksion/veprim te caktuar te Shoqerise, ai do te njoftoje paraprakisht me shkrim Keshillin e Administrimit dhe aksionaret ku do te specifikojne llojin, objektin, kushtet, origjinen dhe shkallen e interest ne transaksion/veprimin e caktuar. Administratori nuk mund te kryeje veprimin ne fjale pa autorizimin paraprak me shkrim te Keshillit te Administrimit. Administratori ka pergjegjesi perkundrejt aksionareve te Shoqerise per cdo veprim apo mosveprim te Shoqerise dhe administrimin e kryer nga keta si edhe per cdo dem qe i shkaktohet Shoqerise si pasoje e veprimeve te tyre apo mosveprimeve te lartpermendura.



**SEKSIONI V**  
**EKSPERTI/ET KONTABEL TE AUTORIZUAR**

**Neni 15 – Eksperti/t Kontabel te Autorizuar**

- 15.1 Kontrolli i brendshem i Shoqerise kryhet nga nje apo me shume eksperte kontabel te autorizuar te cilet emerohen nga Asambleja e Pergjithshme per nje vit financiar.
- 15.2 Eksperti i pare kontabel i autorizuar i Shoqerise eshte "I.L.D-99 AUDIT" shpk.

**TITULLI V**  
**VITI FINANCIAR, FITIMET**

**Neni 16 – Viti Finaciar**

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me date 31 dhjetor te cdo viti.

**Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci, pas zbritjes se rezerves ligjore dhe te gjithe shumave qe Asambleja e Pergjithshme vendos si rezerve, do t`u shperndahen aksionareve me vendim te Asamblese se Pergjithshme.
- 17.2 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose per krijimin e rezervave te jashtezakonshme apo te vecanta.

**TITULLI VI**  
**PRISHJA-SHPERBERJA-BASHKIMI, LIKUIDIMI**

**Neni 18 – Prishja – Shperberja – Bashkimi**

- 18.1 Shoqeria priset ne rastet e parashikuara ne ligjin e zbatueshem. Ne rast prishje, Asambleja e Pergjithshme emerone nje apo me shume likuidues dhe u delegon ketyre kompetencat e duhura.
- 18.2 Gjithashtu, Shoqeria mund te shperbehet apo bashkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 19 – Likuidimi**

- 19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 19.2 Per administrimin e kesaj procedure, Asambleja e Pergjithshme emerone nje apo me shume likuidues, i cili do te pergatise raportin perfundimtar lidhur me aktivin dhe pasivin e Shoqerise si dhe per procedurat e likuidimit e kohen e nevojshme per likuidimin.
- 19.3 Pas perfundimit te procedures se likuidimit, Asambleja e Pergjithshme do te marre vendim per bilancin perfundimtar, punen e kryer nga likuiduesi/t dhe perfundimin e procedures se likuidimit.





- 19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive te paguara, likuiduesi/t do t'u shperndajne aksionareve aktivet e mbetura ne proporcion me aksionet e tyre.

## **TITULLI VII**

### **TE NDRYSHME**

#### **Neni 20 – Gjuha**

- 20.1 Ky akt themelimi dhe statut eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne shqip.

#### **Neni 21 – Ligji i zbatueshem dhe Juridiksioni**

- 21.1 Ky Statut rregullohet nga ligji Shqiptar ne fuqi dhe cdo mosmarreveshje qe lind nga dhe ne lidhje me kete Statut do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 21.2 Cdo ceshtje qe nuk rregullohet shprehimisht ne kete Statut do te rregullohet nga Ligji Shqiptar Nr. 9901, date 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar.

\*\*\*\*\*

### **AKSIONARI I VETEM**

**Kujtim BUCALIU**

**(I perfaqsuar me Prokure nga Ndue Pjetrushaj)**

*Ndue Pjetrushaj*

---

*[Signature]*

Tirane, me 29 Janar 2024